



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

FUNKSIONET DHE FORMAT E BANKINGUT

Kapitulli 2

Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku

Ph.D. Fisnik Morina



MARS, 2018



MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

2

- Lënda: Menaxhimi i Riskut Financiar
- Viti I-rë, Semestri II, Departamenti: KF (Master)
- Statusi i lëndes: Obligative
- Javët mësimore: 15 (3 orë ligjerata, 2 orë ushtrime)
- Mësimdhënes: Prof. Asoc. Dr. Ibish Mazreku
Ph.D. Fisnik Morina
- Emaili: ibish.mazreku@unhz.eu
fisnik.morina@unhz.eu

SHËRBIMET THEMELORE TË BANKAVE

3

Bankat ofrojnë shumë produkte dhe shërbime. Edhe pse ka dallime në mes të bankave nëpër rajone, shërbimet kryesore që bankat tradicionalisht i ofrojnë janë:

- **Mbledhja e depozitave** – është proces i pranimit të hollave të gatshme ose të hollave (depozitat) nga individët dhe bizneset (depozituesit) për ruajtje në një llogari në bankë, në dispozicion për përdorim në të ardhmen.
- **Shërbimet e pagesave** – është proces i pranimit dhe kryerjes së pagesave në emër të klientëve duke përdorur llogaritë e tyre bankare.
- **Dhënja e kredive** – është proces i vlerësimit dhe i vendosjes për klientët (huamarrësit) se a kanë aftësi të marrin kredi dhe pastaj lëshimi i huasë apo kredisë për klientët.

BANKAT NË EKONOMI

4

Përmes ofrimit të shërbimeve kryesore bankare tanimë të përmendura, bankat janë lehtësuesit kritikë të aktivitetit ekonomik.

- Bankat i kanalizojnë kursimet nga depozituesit të huamarrësit, një aktivitet i njohur si ndërmjetësim financiar.
- Bankat krijojnë kredi nga depozitat përmes transformimit të asetëve.
- Bankat, përmes ndërmjetësimit financiar dhe transformimit të asetëve, angazhohen në krijimin e parasë së re.

KRIJIMI I PARASË

5

- Bankat fitojnë të ardhura nga ndërmjetësimi financiar/procesit të transformimit të aseteve nga konvertimi i depozitave të klientëve në kredi.
- Megjithatë, për të qenë fitimprurëse, normat e interesit që banka fiton në kreditë e saja duhet të jenë më të mëdha se normat e interesit që ajo i paguan mbi depozitat që i financojnë ato.
- Pasi që shumica e depozitave mund të tërhiqen në çdo kohë, banka duhet të balancojë qëllimin e të ardhurave më të larta (duke investuar shumicën e depozitave për të financuar kreditë) me nevojat që të ketë të holla në dorë për të përmbushur kërkesat e tërheqjes së depozituesve.
- Për ta bërë këtë, bankat "rezervojnë" një pjesë relativisht të vogël të fondeve të tyre të depozitave për të përmbushur kërkesat e depozituesve.

SHËRBIMET E PAGESAVE

6

- Depozituesit mund të përdorin llogaritë e tyre të depozitave në banka për të bërë dhe për të pranuar pagesa midis depozituesve dhe midis bankave.
- Pagesat i referohen trajtimeve të transaksioneve financiare ndërmjet palëve dhe zakonisht përfshijnë transferimin e fondeve në mes të palëve.
- Ekzistojnë sisteme të ndryshme të pagesave që lehtësojnë transferimin e fondeve për transaksione, duke përfshirë çeqet, urdhër pagesat, pagesa e faturave dhe pagesat elektronike në formë të shërbimeve të telit dhe sistemet e tjera elektronike të pagesave.
- Sistemet e pagesave gjithashtu mund të ndihmojnë korporatat e mëdha dhe organizatat qeveritare të trajtojnë pagesat e tyre për mallra dhe shërbime.

SHËRBIMET TJERA BANKARE

7

- Përveç shërbimeve kryesore, bankat zakonisht ofrojnë edhe shërbime të tjera financiare, ndonjëherë në konkurrencë me ofruesit tjerë të shërbimeve financiare jobankare që zakonisht përfshijnë kompanitë e financave, firma brokerimi, konsulentëve të menaxhimit të rrezikut, dhe kompanive të sigurimit.
- Bankat dhe kompanitë që ofrojnë këto shërbime zakonisht marrin tarifa, ose "të ardhura nga tarifa", për ofrimin e këtyre shërbimeve.

LLOJET E BANKAVE

8

- BANKINGU I SHITJES ME PAKICË (RETAIL BANKS)
- Klientët kryesorë të bankingut me pakicë janë individët, ose "konsumatorët".
- Bankingu retail gjithashtu ofron shërbime për ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM). Bankat me pakicë mund të kenë specializime të ndryshme:
- Retails dhe bankat e konsumit, kompanitë e kursimeve dhe kredive (thrifts, shoqëritë e ndërtimit), kooperativat, dhe unionet e kreditit.

- Firmat bankare private. Këto ofrojnë shërbime të menaxhimit të pasurisë, duke përfshirë tatimet dhe këshilla të investimeve, zakonisht për individë të pasur (p.sh., Coutts & Co në Mbretërinë e Bashkuar dhe Banka e Julius Baer në Zvicër).
- Bankat postare. Këto ofrojnë shërbime bankare për klientët në zyrat postare. Kjo strukturë, ku shërbimi postar zotëron ose bashkëpunon me një bankë, është përdorur gjerësisht në të gjithë botën (p.sh., Postbank AG në Gjermani, Japonia Post Bank në Japoni).

BANKAT ME SHUMICË

- Klientët e bankingut me shumicë kryesisht janë biznese te korporatave dhe jo korporatave.
- Edhe pse gama e konsumatorëve të biznesit ndryshon, ajo zakonisht përfshin kompanitë më të mëdha vendore dhe ndërkombëtare.
- Bankat me shumicë gjithashtu ofrojnë shërbime këshilluese të përshtatura për nevojat e veçanta të bizneseve të mëdha.

- **Bankat korrespondente.** Këto ofrojnë shërbime bankare në bankat e tjera, shpesh në një vend tjetër, duke përfshirë kredi dhe alternativa të ndryshme të investimeve.
- **Investive (i quajtur nganjëherë "bankat tregtare").** Këto ofrojnë këshilla profesionale për korporatat dhe qeveritë për ngritjen e fondeve në tregjet e kapitalit të tilla si tregjet e aksioneve, bonove, apo te kreditit.

HOLDING KOMPANITË E BANKAVE

12

- Holding kompanitë bankare janë kompani që zotërojnë një apo më shumë banka, por që nuk kryejnë vetë veprimtari bankare.
- Holding kompanitë bankare janë kryesisht një tipar i sistemit bankar amerikan ku rregullatorët ishin të shqetësuar që të kufizojnë aftësinë e bankave për t'u angazhuar në aktivitete jo bankare.
- Holding kompanitë bankare mund të zotërojnë filiale që, ne mes tyre, mbulojnë një gamë të plotë të aktiviteteve të shërbimeve financiare, por secili institucion operativ individual është angazhuar vetëm në një sektor të kufizuar të tregjeve financiare.

BANKAT KOOPERATIVE

13

- Bankat kooperativë janë në pronësi të klientëve të tyre dhe zakonisht kanë rrjet të madh të degëve që mbulojnë qytete të vogla dhe fshatra, si dhe qytetet e mëdha.
- Forca e tyre kryesore është kreditimi dhe marrja e depozitave nga individët dhe bizneset e vogla.
- Për shumicën e bankave, ka një dallim në mes të aksionarëve, të cilët investojnë në bankë dhe për këtë arsye i zotërojnë ato, dhe konsumatorëve, të cilët bëjnë biznes me bankën por nuk kanë pronësi në to.
- Në të kundërtën, dikush që depoziton para me një bankë kooperative automatikisht bëhet aksionar në atë bankë kooperative.

UNIONET E KREDITIT

- Unionet e kreditit janë të ngjashme me bankat kooperativë në atë se ato janë në pronësi të klientëve të tyre.
- Megjithatë, në praktikë, unionet e kreditit kanë tendencë të jenë të vogla, të lidhura afër me komunitetin e tyre lokal, dhe të fokusuar në plotësimin e nevojave të grupeve me të ardhura të ulëta.
- Shpesh, konsumatorët mund të marrin hua nga unioni i kreditit vetëm nëse ata gjithashtu kanë një llogari kursimi aty.

INSTITUCIONET MIKRO - FINANCIARE

15

- Institucionet mikrofinanciare (IMF) ekzistojnë për të dhënë shuma të vogla të parave për konsumatorët me të ardhura të ulëta, zakonisht në vendet në zhvillim.
- Shumat mund të jenë aq të vogla si 20 euro, edhe pse ata nganjëherë mund të arrijnë shumën e disa mijëra eurove.
- Qëllimi i këtyre kredive është që t'iu mundëson klientëve që të ngritën nga varfëria dhe të bëhen më të pavarur ekonomikisht, për shembull, duke blerë materiale me të cilat prodhojnë mallra të thjeshta që pastaj mund të shiten në tregun lokal.

BANKAT QENDRORE

16

- Bankat qendrore janë autoriteti kryesor monetar i një vendi (ose, herë pas here, një grup vendesh) dhe janë vendimtare për funksionimin e të gjitha bankave, tregjeve financiare dhe të ekonomisë.
- Bankat qendrore menaxhojnë sasinë e parave dhe të kredisë në një ekonomi -zakonisht në një përpjekje për të përmbajtur normën e inflacionit dhe / ose për të nxitur rritjen ekonomike.
- Ato zakonisht e realizojnë këtë nëpërmjet aktiviteteve të tyre të përditshëm duke blerë dhe shitur borxhin e qeverisë, përcaktimin dhe ruajtjen e normave bazë të interesit, duke përcaktuar nivelet e rezervës së detyrueshme, dhe emetimin e parasë.

RISKU BANKAR

Ka përkufizime të shumta të rrezikut. Gjithkush ka një përkufizim të asaj se çka është rreziku, dhe të gjithë e njohin një gamë të gjerë të rreziqeve. Disa nga përkufizimet më gjerësisht të diskutuara të rrezikut përfshijnë si në vijim:

- Gjasat që një ngjarje e padëshirueshme do të ndodhë,
- Madhësia e humbjes nga një ngjarje e papritur
- Probabiliteti se "gjërat nuk do të shkojnë mirë"
- Efektet e një rezultati të kundërt

Akordi Bazel III, më e fundit e këtyre marrëveshjeve, fokusohet kryesisht në katër lloje të rrezikut :

1. Rreziku i kredisë
2. Rreziku i tregut
3. Rreziku operacional
4. Rreziku i likuiditetit

RISKU KREDITOR

- Rreziku i kredisë është rreziku që një huamarrës i bankës, i njohur gjithashtu si kundërpalë, mund të dështojë që ti përmbushë detyrimet e tij - të paguajë interesin në kredi dhe të paguajë shumën e marrë hua - në përputhje me kushtet e rëna dakord.
- Rreziku i kredisë është rreziku më i madh që shumica e bankave e hasin dhe vjen nga mundësia që kreditë ose bonot e mbajtur nga banka nuk do të paguhen pjesërisht ose plotësisht.
- Rreziku i kredisë është shpesh sinonim me rrezikun e mospagimit.

RISKU I TREGUT

20

- Rreziku i tregut është rreziku i humbjeve të bankës që rrjedhin nga lëvizjet në çmimet e tregut si rezultat i ndryshimeve në normat e interesit, kurset e këmbimit dhe të çmimeve të ekuitetit dhe të mallrave.
- Komponentët e ndryshëm të riskut të tregut, dhe forcat që ndikojnë në rritjen e tyre.
- Komponentët e rrezikut të tregut janë si më poshtë:
 - ▣ **Rreziku i normës së interesit** është humbja e mundshme për shkak të lëvizjeve në normat e interesit. Ky rrezik lind sepse asetet e bankës (kreditë dhe obligacionet) zakonisht kanë maturitet konsiderueshëm më të gjatë se sa detyrimet e bankës (depozitat)..

- ▣ **Rrezikut të ekuitetit** është dëmi potencial për shkak të një ndryshimi të pafavorshëm në çmimin e aksioneve. Aksionet, gjithashtu referohen si aksione apo kapital, përfaqëson një interes pronësie në kompani.
- ▣ **Rreziku i kursit të këmbimit** është rreziku që vlera e asetëve ose të detyrimeve të bankës të ndryshojë për shkak të luhatjeve të kursit të këmbimit valutor.
- ▣ **Rreziku i mallrave** është dëmi potencial për shkak të ndryshimit të pafavorshëm në çmimet e mallrave. Ka lloje të ndryshme të mallrave, duke përfshi mallrat bujqësore (p.sh., gruri, misri, soja), mallrat industriale (p.sh., metalet), dhe mallrat e energjisë (p.sh., gazi natyror, naftë bruto).

RISKU OPERACIONAL

22

- Rreziku operacional është rreziku i humbjes që rezulton nga proceset, njerëzit, dhe sistemet e brendshme të pamjaftueshme ose të dështuara ose nga ngjarjet e jashtme.
- Ky definicion përfshin rrezikun ligjor, por përjashton rrezikun strategjik dhe të reputacionit.

RISKU I LIKUIDITETIT

23

- Rreziku i likuiditetit është rreziku që një bankë të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj për të shlyer depozitat dhe fonde të tjera, ose të vazhdojë financimin e aseteve të saj.
- Ka qenë një fokus shumë më i madh në rrezikun e likuiditetit të bankave në veçanti pas krizës globale financiare të viteve 2007-2009, kur disa banka kishin nevojë për tu mbështetur nga qeveritë e tyre për shkak se ato nuk ishin në gjendje për të përmbushur detyrimet e tyre për të paguar depozituesit dhe bartësit e bondeve.

RREZIKU I SISTEMIT

- **Rreziku i sistemit** i referohet mundësisë që një sistem i tërë bankar të mund përballet me humbje apo edhe kolaps, duke u prekur të gjitha bankat që operojnë në këtë sistem.
- Rreziku i sistemit mund të lind për shkak të ngjarjeve makroekonomikë apo monetare, të tilla si një zhvlerësim i monedhës, ose ajo mund të rezultojë nga dështimi i vetëm një institucioni financiar "sistematikisht të rëndësishëm", problemeve të tilla të cilat shkaktojnë vështirësi për të gjithë bankat tjera në sistem.


FORCAT QE FORMESOJNE INDUSTRIIN BANKARE

25

- **Rregullimi, derregullimi, dhe globalizimi.**
- **Konkurrenca.** Bankat janë duke u përballur me konkurrencën në rritje nga ofruesit e shërbimeve të specializuara financiare. Shembuj të tillë ndërmjetësuesve financiar jo-depozitarë që tani konkurrojnë me bankat përfshijnë:
 - Sistemet pensionale – planet e pensioneve dhe fondet e daljes në pension
 - Pullet e përbashkëta investive – fonde të përbashkëta, njësi truste, dhe hedge fondet
 - Kompanitë financiare - leasing financimi i pajisjeve
 - Shërbimet e pagesave
 - Kompanitë e sigurimeve
 - Hedge Fondet
 - Kompanitë private të ekuitetit.

- **Securitizimi.** Lidhja së bashku e asetëve të ndryshme të borxhit të kapitalit, të tilla si hipotekat, kartat e kreditit, dhe kreditë, dhe shitjen e letrave me vlerë që përfaqësojnë lloje të ndryshme të pronësisë në portofolin rezultues, është produkt financiar relativisht i ri.
- **Përparimet teknologjike.** Përmirësimet në pushtetin e informatikës, telekomunikacionit, dhe teknologjisë së informacionit iu kanë lejuar bankave të ofrojnë ndërmarrësi të reja të tilla si shërbimet bankare të bazuar në Internet. Përparimet teknologjike vazhdojnë të ulin koston e shërbimeve rutinë bankare, të tilla si pagesat dhe tërheqjet.

MATRICA E VARIANCES - KOVARIANCES



Përcaktimi i kthimit të pritur për portofolin

$$\bar{R}_p = \sum_{j=1}^m (W_j)(\bar{R}_j)$$

\bar{R}_p – kthimi i pritur për portofolin

W_j – është pesha (% e investimeve) për asetin (j) në portfolio

m – numri total i asetëve në portfolio

\bar{R}_j – kthimi i pritshëm i asetit (j)

Përcaktimi i devijimit standard të portofolit

$$\sigma_p = \sqrt{\sum_{j=1}^m \sum_{k=1}^m W_j W_k \sigma_{j,k}}$$

W_j – është pesha (% e investimeve) për asetin (j) në portfolio.

W_k - është pesha (% e investimeve) për asetin (k) në portfolio.

$\sigma_{j,k}$ – është kovarianca midis kthimeve për asetin (j) dhe (k) në portfolio.

Kovarianca

$$\sigma_{j,k} = \sigma_j \sigma_k r_{j,k}$$

σ_j – devijimi standard i asetit (j) në portofol

σ_k – devijimi standard i asetit (k) në portofol

$r_{j,k}$ – koeficienti i korrelacionit midis asetëve (j) dhe (k) në portofolio.

Koeficienti i korrelacionit është një masë e standartizuar statistikore e marrëdhënies lineare mes dy variablave.

Vargu i saj është nga:

-1, 0 (korrelacioni perfekt negativ)

0 (nuk ka korrelacion)

+1,0 (korrelacion perfekt pozitiv).

Portfolio me dy asete

Shembulli 1: Korporata “Migros” ka një portfolio të letrave me vlerë, të përbërë nga aksionet D dhe aksionet B.

Kjo korporatë ka investuar 2000 euro në aksionin B dhe 3000 euro në aksionin D.

Kthimi i pritur dhe devijimi standard i aksionit B është 9% dhe 13.15%, ndërsa kthimi i pritur dhe devijimi standard i aksionit D është 8% dhe 10.65%.

Koeficienti i korrelacionit ndërmjet B dhe D është 0.75.

Portfolio me 3 asetë

Shembulli 2:

	Aksioni A	Aksioni B	Aksioni C
Investimi	3500	2100	2400
Kthimi i pritur	7%	8.4%	9%
Devijimi standard	6.5%	7.5%	8.2%

Koeficienti i korrelacionit ndërmjet aksioneve A dhe B është 1.13

Aksioni A dhe C është 0.92

Aksioni B dhe C është 0.81

PËRFUNDIMI I KAPITULLIT TË II-të

